



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ENERGJISË
DHE INDUSTRIË

DREJTORIA E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT TE MINIERAVE ✓

Nr. 1310/1

Tirane, date 10.1.3/2016

Drejtuar: **Z. ABEDIN KATANA**
SHOQERIA "EDITI - A" SHPK
LAGJIA "DARDANIA"

BAJRAM CURRI

Për njoftim: **Z. DAEL DERVISHI, DREJTOR EKZEKUTIV**
AGJENCIA KOMBETARE E BURIMEVE NATYRORE
BULEVARDI "BAJRAM CURRI" BLOKU "VASIL SHANTO"

TIRANE

Z. RRAPUSH TOLA, DREJTOR
REPARTI INSPEKTIM-SHPETIMIT TE MINIERAVE
RRUGA "LORD BAJRON", LAPRAKE

TIRANE

Lënda: Njoftim për fillim procedurash revokimi te lejes nr.231 date 29.12.1995.

I nderuar z. Katana,

Shoqëria "Editi - A" shpk është zotëruese e lejes minerare te shfrytëzimit nr.231 date 29.12.1995 për mineral kromi, ne objektin "Maja e Gjate, Linza 2", Tropoje, ne Qarkun Kukës.

Leja juaj është dhëne me Ligjin nr.7796 date 17.02.1994 "Minerar te Shqipërisë" te ndryshuar qe është shfuqizuar me ligjin nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë", te ndryshuar.

Sipas nenit 57 pika 2 dhe 3 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë", te ndryshuar, përcaktohet shtrirja e efekteve edhe për lejet e dhëna përpara hyrjes ne fuqi te këtij ligji.

Leja juaj është dhëne për një afat fillestar për 20 vite dhe ky afat vlefshmërie ka mbaruar me date 29.12.2015. Ne zbatim te pikës nr.1 te nenit 16 e te germës "ë" te nenit 18 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë", te ndryshuar, ju keni aplikuar pranë Qendrës Kombëtare te Licencimit, për zgjatjen e këtij afati edhe për 10 vite te tjera, një vit përpara përfundimit te afatit fillestar.

Shoqëria juaj duhet te kishte plotësuar kërkesat pikës nr.2 te nenit 16 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë", te ndryshuar dhe VKM nr.362 date 29.04.2011 "Për miratimin e kriterëve dhe rregullave te transferimit, mënyrës se aplikimit për shtyrjen afateve dhe shndërrimit te lejeve minerare". Nga AKBN-ja jeni njoftuar me shkresën e saj nr.9497 date 26.10.2015 "Mbi shqyrtimin e dokumentacionit te aplikimit për shtyrje afati për Leje

